

20161423410

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR NËPUNËS ADMINISTRATIVË

Neni 1

Në Ligjin për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15, 154/15 dhe 5/16), në nenin 7 paragrafi (5) shlyhet.

Në paragrafin (6) fjalët: „paragrafët (4) dhe (5)“ zëvendësohen me fjalët: “paragrafi (4)“.

Neni 2

Në nenin 18 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

“(4) Kompensimi paguhet në llogarinë e të hyrave personale të Agjencisë, më së voni 15 ditë para fillimit të procedurës nga paragrafi (2) i këtij neni.”.

Neni 3

Në nenin 24 paragrafi (2) pika g) fjala “vërtetim” zëvendësohet me fjalën “dëshmi”.

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

“(4) Dëshmia për provim të dhënë për menaxhim administrativ nga paragrafi (2) pika g) e këtij neni, mund të shfrytëzohet gjatë aplikimit në konkurs intern ose publik për vende të punës nga kategoria B, në afat prej pesë vitesh nga data e lëshimit të saj.”

Neni 4

Në nenin 59 në paragrafin (2) fjalët: “që ka ndjekur trajnim për menaxhim administrativ” shlyhen.

Në paragrafin (3) në alinenë 1 fjalët: “rregullat e veçanta nga sfera e vendit të punës dhe” shlyhen.

Neni 5

Në nenin 101 në paragrafin (1) alineja 1 shlyhet.

Neni 6

Kandidatët për plotësimin e vendit të punës nga kategoria B, detyrohen ta dorëzojnë dëshminë për provim të dhënë për menaxhim administrativ të përcaktuar në nenin 24 paragrafi (2) pika g) e këtij ligji, duke filluar nga 13 shkurti 2017.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".